



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E MJEDISIT

AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E SHQYRTIMIT DHE MONITORIMIT TË LEJEVE MJEDISORE DHE
VNM

AN070520260065

13.06.2026

Tiranë, më:

Komisioni

50

DEKLARATË MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” të ndryshuar, VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore” të ndryshuar dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

VENDOSI:

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

Person Juridik: “A-K-KANINA” Sh.p.k

Nr. NIPT-i: L06509202T

Adresa e selisë: Fshati Kaninë, godinë private, Fushe – Kaninë, Qëndër – Vlorë ,Vlorë;

Personi përgjegjës: Andrea Todi

Për të zhvilluar projektin: “**Instalime për mbarështimin intensiv të pulave që rriten për veze**”.

Aplikimi është bërë referuar Ligjit Nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për Verësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, 17. Instalime për mbarështimin intensiv të pulave ose derrave me mbi / a) 1 000 krerë për pulat që rriten për mish, 20 000 vende për pulat që rriten për vezë;

Vendndodhja: Qëndër – Vlorë, Kanine, fshati Kaninë, godinë private, Fushe – Kaninë, Vlorë;

Të dhëna teknike:

Sipërfaqja: 4200 m²

Kapaciteti i projektuar është 32.000 vende për pulat që rriten për vezë

(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen ngazhviluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:

Drejtoritë Teknike të Ministrisë shprehen Drejtoria e Klimës shprehet me rekomandimet si më poshtë vijon:

Në zbatim të legjislacionit përkatës për fushën e menaxhimit të kimikateve, sugjerohet që gjatë fazës së ndërtimit, të mbahen në konsideratë rekomandimet e mëposhtme:

- Subjekti dhe punonjësit duhet të jenë të familjarizuar dhe të respektojnë në mënyrë rigorozë masat dhe rekomandimet për mbrojtjen, sigurinë e njeriut dhe mjedisit, nga kimikatet që do të përdoren për qëllime të këtij aktiviteti, në zbatim të ligjit nr. 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”;

- Kimikatet ose produktet/artikujt që i përmbajnë ato, që do të përdoren, të jenë të klasifikuara, etiketuara, paketuara dhe të shoqërohen me dokumentacionin me të dhënat e sigurisë kimike (MSDS), sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi (VKM-së nr. 488, datë 29.6.2016 “Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve”, si dhe

VKM-së nr. 9, datë 9.1.2019 “Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati I dokumentit me të dhënat e sigurisë”);

- Kimikatet ose produktet/artikujt që i përmbajnë ato, që do të përdoren, të ruhen dhe menaxhohen në mënyrë të sigurt, në zbatim të ligjit nr. 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”.

• Në zbatim të legjislacionit përkatës për fushën e ndryshimeve klimatike, rekomandohet:

- Të kryhen punime miqësore me mjedisin dhe të përdoren materiale të rinovueshme dhe lokale, ndërtesa të jetë ekologjikisht efçente dhe e mirë-izoluar;

- Të krijohen hapësira të gjelbra rreth objektit.

Drejtoria e Ekonomisë Qarkulluese shprehet: Aplikuesi duhet të përmbushen detyrimet për menaxhimin e mbetjeve, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, në fushën e mbetjeve, si më poshtë vijon:

• Të zbatohet Ligji nr. 10 463, date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.

• Të respektohen kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 418, date 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”.

• Mbetjet që do të krijohen, të specifikohen sipas kodeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”.

• Transferimi i mbetjeve jo të rrezikshme të shoqërohet me plotësimin e shtojcës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 229, datë 23.04.2014, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”, të ndryshuar. Në raport citohet VKM e pandryshuar.

- Mbetjet e rrezikshme, të dorëzohen sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 371, date 11.06.2014 “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, të ndryshuar. Në raport citohet VKM e pandryshuar.
- Subjekti që do të transportojë ose do të transferojë mbetjet të jetë i pajisur me licensë III.2.B, si detyrim i nenit 57, të ligjit nr. 10463, date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.
- Për të gjitha mbetjet nga ambalazhet të zbatohet Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 177, datë 06.03.2012, “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”, i ndryshuar.

Në veprimtarinë për të cilën aplikon subjekti, menaxhimi i mbetjeve të bëhet sipas parimit të përgjegjshmërisë ndaj mjedisit, në përputhje me VKM nr. 418, datë 27.5.2020 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020-2035”, duke synuar uljen e sasisë së mbetjeve të gjeneruara dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Drejtoria e Biodiversitetit për këtë aktivitet shpreh se është jashtë fushës së tyre të përgjegjësisë.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet: Bazuar në dokumentacionin e aplikimit, sipërfaqja ku do të zhvillohet aktiviteti: “Instalime për mbarështimin intensiv të pulave që rriten për vezë”, adresa: Vlorë; Qendër – Vlorë, Kaninë, fshati Kaninë, godinë private, Fushë – Kaninë, me zhvillues “A-K KANINA” dhe aplikues “Go-Green Studio”, me nr. Aplikimi AN260120260031, nuk ndodhet brenda rrjetit të zonave të mbrojtura .

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore shprehet Referuar gjurmës së zonës që do të zhvillohet, që rezulton prej koordinatave të konturit të dhëna në Raportin Teknik të paraqitur nga ju, si edhe të dhënave për trupat ujorë sipas shtresës Hidrografia, në Gjeoportalin ASIG, si dhe duke marrë parasysh faktin që objekti është ekzistues dhe nuk do të ketë gjurmë ndërtimi të re, rezulton se projekti i zhvillimit nuk është objekt i legjislacionit për burimet ujore.

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore vlerëson se në raportin e VNM-së paraprake duhet patjetër të merren parasysh dhe të trajtohen edhe elementët/çështjet e mëposhtme:

- Përshkrimi i ndikimeve negative të rëndësishme të aktivitetit të propozuar në cilësinë e ujërave apo ndikime negative shtesë (kumulative) në burimet ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore (nëse ka);
- Informacion i detajuar lidhur me:
 - a. Çdo ndotës/substancë të rrezikshme që shkakton ndotje, që ka gjasa të shkarkohet në burimet ujore nga zhvillimi i këtij aktiviteti të propozuar;
 - b. Të detajohet se cili do të jetë trajtim i përshtatshëm i ujit të ndotur me qëllim që pas shkarkimit, ky ujë i ndotur të mos ndikojë në trupin ujor ku do të shkarkohet dhe t’u mundësojë ujërave pritëse të përmbushin objektivat përkatës të cilësisë mjedisore;
 - c. Të paraqiten masat që subjekti do të marrë lidhur me shkarkimin e ujërave, si dhe me mbetjet, pasi në asnjë mënyrë nuk duhet që këto ujëra të depërtojnë në akuifer.
- Në programin e monitorimit të ndikimeve në mjedis gjatë zbatimit të aktivitetit të përfshihen edhe ndotësit/substancat e rrezikshme që shkaktojnë ndotje ujërave pritëse, si dhe të përcaktohet vlera kufi e emetimit për secilin nga ndotësit/substancat e rrezikshme të identifikuar, që mund të shkarkohen në trupat ujorë gjatë zhvillimit të aktivitetit, të shprehura në termat e parametrave specifike të sigurt, përqendrimit ose nivelit të emetimit, që nuk duhet të tejkalohet gjatë një ose më shumë periudhave kohore.

Agjencia Rajonale e Mjedisit shprehet: Në vijim të zbatimit të Ligjit Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” i ndryshuar, Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 10440 , datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, dhe akteve nënligjore mjedisore në fuqi, Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë, jep mendimin se subjekti duhet të vazhdojë procedurat përkatëse për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Të Thelluar).

Bashkia Vlore shprehet se Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM 828, datë: 28.12.2023, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e

Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar, aplikimi për “VNM E THELLUAR-Njofim” për objektin “Instalime për mbarëshkrimin intensiv të pulave që rriten për vezë ”, është në rregull për tu pajisur me raportin e VNM-së së Thelluar.

2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:

Konsultimi me publikun: Dëgjesa është zhvilluar me datë 10.04.2026, ora 11:00 –12:00, në vendin ku do të zhvillohet aktiviteti. Gjatë konsultimit ishin të pranishëm përfaqësues nga AKM/ARM, përfaqësues nga NJQV dhe banorët rreth zonës ku do zhvillohet aktiviteti. Në takim është prezantuar projekti dhe i janë drejtuar pyetje banorëve për ndonjë shqetësim ose problematikë lidhur me ushtrimin e këtij aktiviteti. Të gjithë banorët pjesëmarrës të zonës u shprehen se nuk kishin kundërshtime për këtë aktivitet pasi sjellë zhvillim për zonën dhe punësim.

3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;

Zhvillimi i aktivitetit:

- Nuk prek zona të mbrojtura
- Mendimin e Drejtorive teknike të Ministrisë së Mjedisit
- Mendimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura;
- Mendimin e Agjencisë Rajonale të Mjedisit.
- Mendimin e AMBU-së;
- Mendimine Bashkise Vlore,
- Në mendimin e anëtarëve të Komisionit 50, datë 13.05.2026, i mbledhur në zbatim të Urdhërit nr.15, datë 20.01.2026, nr.1381 prot, për “Krijimin e komisionit për vlerësimin e aplikimeve dhe kërkesave që i nënshtrohen procedurës paraprake e të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis”.

4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme.

- 1.
- 2.
- 3.

3.1 Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit dhe akteve ligjore në fuqi.

3.2 Ky vendim nuk është leje zhvillimi përfundimtare për zbatimin e këtij projekti, por është një dokument i cili lëshohet me kusht që në rast se do të zhvillohet ky aktivitet, duhet të zbatohet kushtet e vendosura si detyrim që vjen nga Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e

Mjedisit”, si dhe Ligji nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, KREU I, Neni 1, Pika a); KREU II, Neni 7, Pika 1; KREU V, Neni 20, Pika 1.

3.3 Ky Vendim është i vlefshëm pasi subjekti të marrë miratim nga institucionet përkatëse për këtë lloj aktiviteti.

3.4 Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tillë si: objekte kulti, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.

3.5 Kjo Deklaratë është e vlefshme pasi subjekti të bëjë heqjen nga Fondi Pyjor, në rast se aktiviteti bie në një të tillë.

3.6 Të kryhen punime vetëm në gjurmët e projektit të propozuar.

4.7. Në asnjë mënyrë mos të ketë prerje pemësh.

4.8. Të bëhet rrethimi i zonës ku do të realizohen punimet, për të shmangur hyrjet e pautorizuara.

4.9. Masa e dheut e gjeneruar nga operacionet e gërmimit, të sistemohet në një vend të caktuar dhe të ruhet për qëllimin e rehabilitimit.

4.10. Të merren masa për të parandaluar rëniet e zjarrit gjatë realizimit të punimeve në terren dhe të sigurohen mjetet e nevojshme të ndërhyrjes në rast të rënies së zjarrit (zjarrfikse të lëvizshme, bombula me shkumë, etj);

4.11. Niveli i zhurmave gjatë procesit të jetë brenda normave të lejuara dhe të punohet në orare kur shqetësimi i banoreve dhe zonave përreth të jetë me ndikim sa më të ulët

4.12. Operacionet për zbatimin e projektit (ndërtimi) të përdorin sa më shumë të jetë e mundur infrastrukturën egzistuese të transportit (rrugën dhe rrjetet egzistuese).

4.13. Subjekti të kujdeset për menaxhimi e mbetjeve të krijuara nga veprimtaria, sidomos ato të ambalazhimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimit e caktura nga njësia vendore.

4.14. Mbetjet organike të vendosen në kontenierë të mbyllur, dhe të trajtohen sipas kushteve të vendosura nga autoritetet kopetente.

4.15. Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme cdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.

4.16. Kompania të ndjek me përpikmëri projektin teknik për të evituar erozionin e tokës, me qëllim ruajtjen e cilësisë së ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

4.17. Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.

4.18. Furnizimi me ujë të pijshëm të bëhet në tubacionin kryesor, me miratimin të Shoqërisë Anonime “Ujësjiellës-Kanalizimeve”.

4.19. Të instalohet impianti i trajtimit të ujërave të ndotura që gjenerohen nga aktivitetit i therjes para shkarkimit të tyre në kanalizimet kryesore.

4.20. Furnizimin me energji elektrike të bëhet konform kërkesave e me miratimin të organeve kopetente.

4.21. Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në ARM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.

4.22. Para fillimit të veprimtarisë të trajtohen të gjithë punëtorët e subjektit si dhe të njihen me termat dhe kushtet e sipercituara në Vendim.

4.23. Të mbillen pemë në të gjithë perimetrin e godinës së shërbimit për të minimizuar ndikimet në mjedis.

4.24. Produktet të magazinohen në ambiente frigoriferike i cili duhet të ndërtohet sipas kushtet teknike, brenda sipërfaqes së ndërtimit të miratuar.

- 4.25. Të respektohen kushtet Higjeno-Sanitare të ambienteve të vendosura nga Instituti i Shëndetit Publik.
- 4.26. Kompania duhet të respektojë gjithashtu edhe kushtet e vendosura në raportin e VNM-së që është paraqitur në aplikim si dhe të ketë parasysh ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
- 4.27. Në përfundim të punimeve, të sillet pranë AKM-së një raport mbi gjendjen e mjedisit të shoqëruar me foto dhe mbi punimet rehabilituese gjatë gjithë vijës së projektit.
- 3.28 Subjekti ka detyrimin e menaxhimit të mbetjeve inerte. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, dhe transporti të kryhet nga subjekte të licensuara të pajisura me Kod Unik Subjekti të kontaktojë me pushtetin vendor për largimin e mbetjeve inerte, që do të gjenerohen gjatë fazës së shëmbjes së objekteve ekzistuese.
- 3.29 Ky Vendim është i vlefshëm pasi subjekti të bej ndryshimin e statusit të tokës, nga tokë arë, në tokë truall, sipas akteve ligjore në fuqi.
- 3.30 Kompania duhet të respektojë të gjitha kushtet teknike të ndërtimit sipas akteve ligjore dhe nën ligjore në fuqi.
- 3.31 Para funksionimit të aktivitetit, subjekti duhet të marrë masa lidhur me trajtimin e ujërave të ndotura dhe ujërave të zeza duke instaluar sistemin e trajtimit ose kanalizimin e tyre me rrjetin kryesorë të zonës.
- 3.32 **Duke qënë se gjatë fazës së funksionimit, ky aktivitet do të ketë efekte në mjedis, në bazë të Ligjit nr.10448, datë 14.7.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, të ndryshuar, Shtojca I, duhet t’i nënshtrohet procedurave për paisje me Leje Mjedisore.**

5.Monitorimi dhe Raportimi

Në bazë të Ligjit Nr. 128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Neni 25/1 “Monitorimi dhe vlefshmëria”, zhvilluesi ka detyrimet si më poshtë:

- Zhurma dhe Vibracionet

- Të zbatohen nivelet kufi të zhurmës, referuar Udhëzimi i Përbashkët Nr. 2, datë 15.11.2023 “Për nivelet kufi të zhurmave për një mjedis të dhënë dhe për fushën e veprimtarive ekonomike- shoqërore” dhe Ligjit Nr.9774 date 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”
- Të merren masa për mbrojtjen e punonjësve nga zhurmat.
- Të merren masat për kufizimin e orareve të punës në kantier.
- Operatori duhet të parandalojë gjenerimin e zhurmës impulsive në zonat e ndjeshme ndaj zhurmës, gjatë operimit të instalimeve.
- Vibrimet në vende të ndjeshme nuk duhet të kalojë 10 mm/s (PPV) në çdo kohë.
- Të bëhet monitorimi i zhurmave për mjediset: automjete/kamiona në hyrje të kantierit, kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi:

Mjedis	Vlera kufi e zhurmës dB(A)	Vlera kufi e zhurmës dB(A)	Raportimi në AKM	Periodiciteti
--------	----------------------------	----------------------------	------------------	---------------

	Leq, T Ditë	Leq, T Mbrëmje		
Automjete/kamiona në hyrje te kantierit	55	45	14.11.2026	Çdo 6 muaj
Kantier ndertimi	55	45	14.11.2026	Çdo 6 muaj
Mjedisi urban më i afërt me kantierin	55	45	14.11.2026	Çdo 6 muaj

- Shkarkimet në Ajër

- Të zbatohen nivelet kufi të shkarkimeve në ajër, referuar Ligjit Nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis” dhe VKM Nr. 248, datë: 24.03.2003 “Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe Zbatimin e tyre”.
- Shkarkimet në ajër të jene brenda normave të lejuara, duke marrë masa për reduktimin e tyre.
- Kantieri në të cilin emetohen lëndë grimcore në ajër, duhet të pajiset sipas mundësive teknike dhe mbi bazën e natyrës së procesit, me rrjeta uji / sisteme spërkatje / sisteme heqje pluhurash.
- Të bëhet monitorimi i nivelit të pluhurave në ajër, për mjediset: kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afërt me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lënda grimcore (PM _{2.5})	20-25 µg/m ³	14.11.2026	Çdo 6 muaj
PM ₁₀	50 µg/m ³ , 40 µg/m ³	14.11.2026	Çdo 6 muaj

- Cilësia e ujrave

Parametrat që duhet të monitorohen

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lëndët në pezulli	50 mg/l	14.11.2026	Çdo 6 muaj

- Subjekti duhet të sjellë pranë AKM-së si më poshtë:

- Informacion në momentin e fillimit të punimeve.
- Informacion për menaxhimin e mbetjeve inerte. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, dhe transporti të kryhet nga subjekte të licensuara, të pajisura me Kod Unik.
- Raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen sipas datës së raportimit/ çdo 6 muaj.
- Informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto.

- Afati i Vlefshmërisë

- Vendimi për Deklaratë Mjedisore për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.
- Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Marjeta Përlala

MINISTRI

SOFJAN JAUPAJ

Aneksi 1. Harta me koordinatat

Koordinatat e vendndodhjes sipas sistemit Albanian 1986/Gaus Kruger Zone 4 (referuar lejes minerare) *Koordinatat e vendndodhjes sipas sistemit KRRGJSH (referuar lejes minerare)*

NR.	E	N
1.	4375259.66	4482576.47
2.	4375361.70	4482529.96
3.	4375338.51	4482488.73
4.	4375243.84	4482554.44

NR.	E	N
1.	459940.36	4481511.73
2.	460042.90	4481466.38
3.	460020.19	4481424.90
4.	459924.80	4481489.52

